

## AKT THEMELIMI I SHLIVIA SHPK

Sot me date 01/08/2021, une i nenshkruari: Z. **Shkëlqim Turku**

I biri i Bedri, lindur ne Tirane, dhe banues ne Tirane, shpreh vullnetin per hartimin e ketij Akti Themelimi te Shoqerise **SHLIVIA SHPK** si me poshte vijon:

**1. FORMA LIGJORE “ SHPK”**, eshte nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar.

**2. ORTAK I VETEM THEMELUES** Ortak i vetem, themelues i shoqerise eshte **Z. Shkëlqim Turku**.

**3. OBJEKTI** Objekti i veprimtarise te shoqerise **SHLIVIA SHPK** eshte:

- Ushtrim i veprimtarise se transferimit te parave ne emer dhe per llogari te subjektit financiar jo-banke AK-INVEST sh.a.
- Kembim Valutor

#### 4. SELIA

Selia e shoqerise tregtare **SHLIVIA SHPK** do te jete ne adresen: Tirane, Rr. Bajram Curri, Godina 519, Hyrja 2, Ap. 8, ZK. 8120, Nr. Pas. 7/258+2-8..

#### 5. KOHEZGJATJA

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj, sipas objektit, per nje periudhe kohore te pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar. Afati i permendur ne piken 1 te ketij neni mund te shkurtohet apo zgjatet me vendim te Ortakut te vetem te shoqerise, ne perputhje me rregullat e percaktuara nga Statuti i Shoqerise.

#### 6. KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar i shoqerise tregtare **SHLIVIA SHPK** eshte 2.500.000 Leke (dy milion e peseqind mije). Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1 kuote dhe vlere nominale e nje kuote eshte 2.500.000 Leke (dy milion e peseqind mije leke). Ortaku i vetem eshte zoteruesi i te gjitha kuotave te shoqerise, ne vleren 100% te

tyre. Kuotat jane nominative dhe nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere.  
Cdo kuote perfaqeson te drejten e nje vote.

## 7. ORTAKU I VETEM

Ortaku i vetem ushtron kompetencat qe ligji i jep Asamblese se Ortakeve.

## 8. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Shoqeria drejtohet nga Administratori. Administrator i pare i shoqerise  
SHLIVIA SHPK eshte Znj. Livia Turku

## 9. SHPERBERJA DHE LIKUIDIMI

Shperberja dhe likuidimi i shoqerise tregtare mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak ligjor, duke perfshire dhe falimentimin, privimin per te ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe te cdo faktori tjeter qe nuk varet nga vullneti i ortakeve te shoqerise.

Themeluesi

Z. Shkëlqim Turku

( Shkëlqim Turku )